



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**PSH.nr.583/20**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina – panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “N.T. Biti Com” – Podujevë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “Lulishtja Buqaj”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me drunj dekorativ” me nr. të prokurimit: 616-20-3113-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – KK Prishtinë, më datë: 24.09.2020, mori këtë:

## **V E N D I M**

**I. APROVOHET**, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “N.T. Biti Com” – Podujevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me drunj dekorativ” me nr. të prokurimit: 616-20-3113-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – KK Prishtinë.

**II. VËRTETOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me drunj dekorativ” me nr. të prokurimit: 616-20-3113-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – KK Prishtinë.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**V.** Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues ekonomik “N.T. Biti Com” – Podujevë, aprovet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës .

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues ekonomik "N.T. Biti Com" – Podujevë, që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues "N.T. Biti Com" – Podujevë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 24.08.2020 me nr. 583/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me drunj dekorativ" me nr. të prokurimit: 616-20-3113-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – KK Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7 dhe nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe Rregullat për Tender jo-normalisht të ulët.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 03.09.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 09.09.2020, lidhur me pretendimin ankimorë të OE-ankues sqaron si në vijim:

Eksperti Shqyrtues pas verifikimit dhe vlerësimit të pretendimeve të OE ankuesit, konsideron se Pretendimet e OE ankuesit qëndrojnë të pa bazuara, me faktin se OE i rekomanduari ka ofertuar me një çmim standard. Edhe se AK ka vepruar konform Rregullave për tenderët jo normalisht të ulët pika 3, meqë janë vetëm dy OE të përgjegjshëm ka vazhduar me vlerësim të rregullt (Çmimi më i ulët).

Eksperti Shqyrtues sqaron se OE i rekomanduari në paramasë ka vendosur një çmim standard për tri produktet e kërkuara, gjersa OE ankues në paramasë ka vendosur çmime të ndryshme por që bie ndesh me faturën të cilën e ka bashkangjitur në ankesë, duke tentuar të dëshmojë se OE i rekomanduari në paramasën e tij ka vendosur çmime abnormalisht të ulëta.

Eksperti shqyrtues po ashtu sqaron se në paramasën e OE të rekomanduarit çmimi për tri produktet e kërkuara është 15 euro!

1. Abies Fraser 130cope\*15 euro
2. Cedrus Atlantica 130cope\*15 euro

3. Tilia Europaeapallida 20cope\*15 euro
  - Kurse cmimet në paramasën e OE ankuesit janë:
  4. Abies Fraser 130cope\*35 euro
  5. Cedrus Atlantica 130cope\*49 euro
  6. Tilia Europaeapallida 20cope\*15 euro
- (Shih paramasat tek faktet e rëndësishme lartë)

Eksperti Shqyrtues që të jetë sa më objektiv, ka hulumtuar në internet rreth çmimeve të këtyre produkteve, më poshtë janë disa çmime referente të gjetura në internet sa i përket produkteve të kërkuara në paramasë, të njëjtën kohë janë të bashkangjitura edhe linqet:

<https://ëëë.amazon.it/FRASER-FIR-Abies-fraseri-SEMI/dp/B01LJVNIRO>

Giardino e giardinaggio > Piante, semi e bulbi > Piante da esterno > Alberi



Scorri sopra l'immagine per ingrandirla



#### FRASER FIR Abies fraseri 25 SEMI

Marca: SVI

★★★★☆ 12 voti

Prezzo: 14,99 €

Tutti i prezzi includono IVA.

- Di solito ci vuole circa 1-4 settimane di tempo per consegnare dopo che l'oggetto è stato spedito. Si prega di controllare il tempo di consegna prima di effettuare gli acquisti.
- FRASER FIR Abies fraseri 25 SEMI

14,99 €

Questo articolo non può essere spedito presso l'indirizzo selezionato. Modifica l'indirizzo di spedizione.

Generalmente spedito entro 3-5 settimane.

Quantità: 1



Aggiungi al carrello



Acquista ora

Transazione sicura

Venduto e spedito da Rose Ren.

Beneficia della Protezione al Cliente di Amazon

il tuo indirizzo di consegna: Albania

<https://ëëë.ebay.it/itm/Atlas-Zeder-Cedrus-atlantica-Pflanze-5-10cm-Atlaszeder-Zeder-Raritat/114134260939?hash=item1a92ee9ccb:g:D5UAAOSë1X1dtygo>



Sposta il mouse sull'immagine per eseguire lo zoom

#### Cedrus atlantica Cedrus atlantica pianta 5-10cm Atlas cedro cedro rarità - mostra il titolo originale

Condizione: --

Quantità:

4 disponibili

1 venduto

EUR 14,90


Compralo Subito

Aggiungi al carrello

Aggiungi agli oggetti che osservi

Utente di lunga data

Nessuna restituzione



Scorri sopra l'immagine per ingrandirla



### SAFLAX - Set per la coltivazione - Cedro dell'Atlante - 20 semi - Cedrus atlantica

Visita lo Store di SAFLAX

Prezzo: 9,75 €

Tutti i prezzi includono l'IVA.

- Ogni albero è una pianta individualista che resiste al freddo!
- 20 semi per pacchetto
- Con le istruzioni dettagliate per la propagazione di successo.
- Il nostro set per la coltivazione contiene tutto ciò di cui avrete bisogno per ottenere un buon risultato: una piccola mini-serra (17 (lunghezza) x 10 (ampiezza) x 13 (altezza) cm), il substrato di fibra di cocco asettico e traspirante (blocco secco) e 2 vasi in fibra di cocco per il trapianto che seguirà (cambio di vaso).
- L'imponente Cedro dell'Atlante dalla crescita rapida sviluppa prima la sua figura conica, poi con il passare degli anni acquista la forma sporgente e raggiunge altezze fino a 25 metri. I rami crescono ramificati e irregolari, così che ogni cedro ha un aspetto un po' diverso. Negli alberi giovani la corteccia è ancora grigia e liscia, ment ..... (Nelle foto si può trovare una foto della parte posteriore

9,75 €

Questo articolo non può essere spedito presso l'indirizzo selezionato. Modifica l'indirizzo di spedizione.

Disponibilità immediata.

Quantità: 1

Aggiungi al carrello

Acquista ora

Transazione sicura

Venduto e spedito da SAFLAX.

Beneficia della Protezione al Cliente di Amazon

il tuo indirizzo di consegna: Albania

Aggiungi alla lista

Si përfundim, Eksperti Shqyrtues pas hulumtimit të bërë në internet, konsideron se OE i rekomanduari ka ofertuar me çmim real. Gjersa në ankesë OE ankuesi pretendon:

Po ne si OE N.T BITI - COM kemi futur këtu një faturë për dëshmi se ku tregon se nga vendet e BE-se nga Italia se sa kushton copa përafërsisht e një bredhi dekorativ dhe një druri dekorativ, se nuk është e mundur të bëhet furnizimi me këtë çmim të ulët dhe nuk i plotëson kushtet për dhënie të kontratës OE- LULISHTJA BUQAJ, andaj duhet të merret parasysh Komisioni Rrequllativ i Prokurimit Publik në pajtim me Nenin 87. paraqrafën 2, nën-paraqrafën 2.8 dhe nenin 61, paraqrafën 6, të Liqjit mbi Prokurimin Publik nr. 04ZL-042 , i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237. ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, adopton Rregullat që plotësojnë dhe japin sqarime për tenderët jo-normalisht të ulët.

Eksperti Shqyrtues sqaron se OE ankuesi çmimin e vendosur në paramasë për dallim nga fatura e bashkangjitur në ankesë (si mostër) e ka shumë më të ulët.

Pra, çmimi i produktit në paramasë: 3. Tilia Europaeapallida 20cope\*15 euro

Çmimi i produktit të njëjtë në faturën e dëshmuar në ankesë është

la nuova di corve  
azzano decimo  
località 5 strade

Prunus Laurocerasus h. 100/140 v. 44	20	52,00	1.040,00
Tilia Europaea Pallida cf. 16/18 v. 80 lt.	10	145,00	1.450,00
Abies Picea Pungens h. 200/300 v. 130 lt.			

Çka do të thotë se në faturë e dëshmuar si mostër çmimi është 52 euro për copë!!!

Andaj Eksperti Shqyrtues pretendimin e OE ankuesit e gjen të pa bazuar. (shih më lartë faktet tek faktet e rëndësishme-Fatura si dëshmi dhe Paramasa e dy OE-ve)

Eksperti Shqyrtues konkludon se pretendimet e OE ankuesit nuk qëndrojnë dhe janë të pa bazuara, dhe se vlerësimi i AK-së është bërë konform LPP\_së dhe Rruopp-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar dhe vendimi i Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës të mbetet në fuqi.

Autoriteti Kontraktues me datë: 16.09.2020 me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 11.09.2020 me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 24.09.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas verifikimit dhe vlerësimit të pretendimeve të OE ankuesit “N.T. Biti Com” – Podujevë, konsideron se pretendimet e OE ankuesit janë të pa bazuara, për faktin se OE i rekomanduari për kontratë ka ofertuar me një çmim standard. Edhe AK ka vepruar konform Rregullave për tenderët jo normalisht të ulët, pika 3, meqë janë vetëm dy OE të përgjegjshëm ka vazhduar me vlerësim të rregullt (Çmimi më i ulët).

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduari në paramasë ka vendosur një çmim standard për tri produktet e kërkuara, gjersa OE ankues në paramasë ka vendosur çmime të ndryshme por që bie ndesh me faturën të cilën e ka bashkangjitur në ankesë, duke tentuar të dëshmojë se OE i rekomanduari në paramasën e tij ka vendosur çmime abnormalisht të ulëta.

Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në paramasën e OE të rekomanduarit për kontratë çmimi për tri produktet e kërkuara është 15 euro!

1. Abies Fraser 130cope\*15 euro
2. Cedrus Atlantica 130cope\*15 euro
3. Tilia Europaeapallida 20cope\*15 euro

Kurse cmimet në paramasën e OE ankuesit janë:

4. Abies Fraser 130cope\*35 euro
5. Cedrus Atlantica 130cope\*49 euro
6. Tilia Europaeapallida 20cope\*15 euro

(Shih paramasat tek faktet e rëndësishme lartë)

Paneli Shqyrtues sqaron se eksperti shqyrtues ka hulumtuar në internet rreth çmimeve të këtyre produkteve, më poshtë janë disa çmime referente të gjetura në internet sa i përket produkteve të kërkuara në paramasë, të njëjtën kohë janë të bashkangjitura edhe linqet në raportin e ekspertit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se pas hulumtimit të bërë në internet, konsideron se OE i rekomanduar ka ofertuar me çmim real. Gjersa në ankesë OE ankuesi pretendon:

Po ne si OE N.T BITI - COM kemi futur këtu një faturë për dëshmi se ku tregon se nga vendet e BE-se nga Italia se sa kushton copa përafërsisht e një bredhi dekorativ dhe një druri dekorativ, se nuk është e mundur të bëhet furnizimi me këtë çmim të ulët dhe nuk i plotëson kushtet për dhënie të kontratës OE-LULISHTJA BUQAJ, andaj duhet të merret parasysh Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik në pajtim me Nenin 87. paraqrafën 2, nën- paraqrafën 2.8 dhe nenin 61, paraqrafën 6, të Liqjit mbi Prokurimin Publik nr. 04ZL-042 , i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237. ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, adopton Rregullat që plotësojnë dhe japin sqarime për tenderët jo-normalisht të ulët.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues çmimin e vendosur në paramasë për dallim nga fatura e bashkangjitur në ankesë (si mostër) e ka shumë më të ulët.

Pra, çmimi i produktit në paramasë: 3. Tilia Europaeapallida 20cope\*15 euro

Çmimi i produktit të njëjtë në faturën e dëshmuar në ankesë është:

78 NUOVA DI GIUGNO  
azzano decimo  
ocalità 5 strade

Prunus Laurocerasus h. 100/140 v. 2+	20	52,00	1.040,00
Tilia Europaea Pallida cf. 16/18 v. 80 lt.	10	145,00	1.450,00
Abies Picea Pungens h. 200/300 v. 130 lt.			

Ku, do të thotë se në faturë e dëshmuar si mostër çmimi është 52 euro për copë! Andaj pretendimet e OE ankues janë të pa bazuar ku si dëshmi në raportin e ekspertit janë bashkëngjite fatura si dëshmi dhe Paramasa e dy OE-ve.

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues sqaron se pretendimet e OE ankues lidhur me operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë janë të pa bazuara, ku rezulton se autoriteti kontraktues me rastin e vlerësimit të ofertave ka bërë ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së dhe Rregullave për tenderët jo normalisht të ulët.

Gjithashtu, Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



**Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK- KK Prishtinë

1x1 OE – "N.T. Biti COM" - Podujevë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.